



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.110

19 gusht

2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.543, datë 7.7.2010	Për miratimin e rregullores “Për punë të sigurt me burimet e rrezatimeve jonizuese”.....	5437
Udhëzim i MMPAU nr.2, datë 29.6.2010	Për dokumentacionin e domosdoshëm për të kërkuar leje mjedisore	5452
Udhëzim i MF nr.26, datë 27.7.2010	Për disa shtesa në udhëzimin nr.7, datë 16.6.2003 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar	5454
Kërkesë e MPPT nr.2500/2, datë 30.7.2010	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qukës - Qafë-Pllaçë, loti I.....	5457
Kërkesë e MPPT nr.2845/3, datë 26.7.2010	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qafë-Thanë-Lin-Pogradec, loti I.....	5460
Kërkesë e MPPT nr.3754/3, datë 23.7.2010	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Vlorë-Orikum.....	5464

VENDIM
Nr.543, datë 7.7.2010

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PUNË TË SIGURT ME BURIMET E RREZATIMEVE JONIZUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr.8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për punë të sigurt me burimet e rrezatimeve jonizuese”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
PËR PUNË TË SIGURT ME BURIMET E RREZATIMEVE JONIZUESE

Neni 1

Objekti i rregullores

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave bazë për mbrojtjen e publikut, personave të ekspozuar profesionalisht, pacientëve dhe mjedisit nga ekspozimi ndaj rrezatimeve jonizuese, për sigurinë e burimeve të rrezatimeve, që më tej do të emërtohen si mbrojtje dhe siguri.

Neni 2

Subjektet përgjegjëse për zbatimin e kërkesave të rregullores

1. Subjektet që kanë përgjegjësitë kryesore janë:

a) të gjithë personat fizikë dhe juridikë të licencuar për ushtrimin e veprimtarive të parashikuara në nenin 3 të ligjit “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese” nr.8025, datë 9.11.1995, të ndryshuar;

b) punëdhënësit.

2. Subjektet e tjera të cilat duhet të kenë përgjegjësi sipas rastit:

a) furnizuesit;

b) ekspertët e mbrojtjes nga rrezatimi në qendrat përkatëse;

c) mjekët imazheristë;

d) personeli shëndetësor;

e) ekspertët e kualifikuar;

f) Komiteti i Etikës;

g) çdo palë tjetër, të cilës nga pala kryesore i është deleguar një përgjegjësi specifike.

Neni 3

Detyrimet e përgjithshme të subjekteve

1. Subjektet e përcaktuara në nenin 2 kanë këto detyrime të përgjithshme:

- a) të përcaktojnë objektivat e mbrojtjes dhe sigurisë konform kërkesave përkatëse;
- b) të zhvillojnë, zbatojnë dhe dokumentojnë një program mbrojtjeje dhe sigurie në përputhje me natyrën dhe riskun, të lidhura me praktikën dhe ndërhyrjet nën përgjegjësinë e tyre, të mjaftueshme për të siguruar përmbushjen e kërkesave të legjislativës;
- c) të përcaktojnë masat dhe elementet e nevojshme për të arritur objektivat e mbrojtjes dhe sigurisë, dhe të krijojnë bindjen për sigurimin e burimeve financiare dhe për zbatimin e masave në mënyrë të përshtatshme;
- d) të mbajnë këto masa dhe burime vazhdimisht nën kontroll dhe të verifikojnë vazhdimisht që objektivat e mbrojtjes dhe sigurisë po përmbushen;
- e) të identifikojnë çdo defekt dhe mungesë në masat dhe elementet mbrojtëse të sigurisë, si dhe të ndërmarrin hapat për të korrigjuar dhe parandaluar ndodhjen e tyre;
- f) të vendosin rregulla nëse shihet e nevojshme, për të lehtësuar konsultimin dhe bashkëpunimin ndërmjet palëve përkatëse lidhur me mbrojtjen dhe sigurinë;
- g) të mbajnë shënimet e nevojshme lidhur me delegimin e përgjegjësive nga ana e tyre.

Neni 4

Mospërmbushja e kërkesave nga subjekti

1. Në rastin e shkeljes së ndonjë kërkesë, subjektet kryesore duhet:
 - a) të hetojnë shkeljen dhe shkaqet e saj, rrethanat dhe pasojat;
 - b) të ndërmarrin veprimet e nevojshme për të përmirësuar kushtet që kanë çuar në shkelje të kërkesave dhe të parandalojnë ndodhjen e një situate të ngjashme;
 - c) të komunikojnë në Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimi shkaqet e shkeljes dhe mbi veprimet korrigjuese dhe parandaluese që janë marrë ose duhet të merren.

Neni 5

Detyrimet e përgjithshme për praktikën dhe burimet

1. Praktikë është aktiviteti njerëzor, i cili mund të rrisë ekspozimin e individëve nga një burim artificial ose natyror përjashtojt emergjencat.
2. Detyrimet e përgjithshme për praktikën dhe burimet janë:
 - a) Praktikën, dhe çdo burim brenda një praktike nuk duhet të nxirret, të përpunohet, të projektohet, të prodhohet, të ndërtohet, të montohet, të blihet, të importohet, të eksportohet, të shpërndahet, të shitet, të jepet me qira, të vihet në dispozicion karshi pagesë, të merret, të vendoset, të lokalizohet, të futet në punë, të merret në pronësi, të përdoret, të mirëmbahet, të riparohet, të transferohet, të nxirret nga përdorimi, të çmontohet, të transportohet, të ruhet ose të groposet, për sa kohë që ekspozimi nga kjo praktikë ose burim nuk është përjashtuar nga kërkesat e standardeve, duke përfshirë këtu dhe kërkesat për njoftim ose autorizim.
 - b) Zbatimi i kërkesave në çdo praktikë ose burim brenda praktikës ose në ndonjë nga veprimet e specifikuar në nenin 11 duhet të jetë në përputhje me karakteristikën e praktikës ose burimit dhe riskun e ekspozimit. Duhet gjithashtu të jetë konform kërkesave të specifikuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi.
 - c) Transporti i burimeve radioaktive është subjekt i kërkesave të rregullores përkatëse për transportin e sigurt të materialeve radioaktive dhe të çdo konvente tjetër ndërkombëtare të zbatueshme për Republikën e Shqipërisë.
 - d) Për çdo modifikim ose futje të praktikave ose burimeve të reja, të cilat mund të kenë ndërlikime të rëndësishme për mbrojtjen dhe sigurinë. Personat e licencuar duhet ta njoftojnë Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimi rast pas rasti.

Neni 6

Kërkesat për praktikën

1. Kërkesat për praktikën, përfshijnë:

a) Prodhimin e burimeve dhe përdorimin e rrezatimeve ose lëndëve radioaktive për qëllime mjekësore, industriale, veterinare dhe bujqësore, ose për mësimdhënie, kualifikim, kërkim shkencor që përfshihen në veprimtari të lidhura me përdorimet e mësipërme, që përmbajnë ose mund të përmbajnë ekspozimin ndaj rrezatimeve ose ndaj lëndëve radioaktive në përputhje me ligjin nr.8025, datë 9.11.1995, të ndryshuar.

b) Praktikrat që përfshijnë ekspozimin ndaj burimeve natyrore dhe të tjera, të specifikuara nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi, të cilat kërkojnë kontroll.

Neni 7

Kërkesat për burimet

1. Kërkesat për burimet përfshijnë:

a) Lëndët radioaktive dhe pajisjet që përmbajnë lëndë radioaktive ose prodhojnë rrezatim, duke përfshirë produktet e konsumit, burimet e mbyllura, burimet e hapura dhe gjeneratorët e rrezatimit.

b) Instalimet që përpunojnë lëndë radioaktive, si dhe ato që trajtojnë mbetjet radioaktive.

c) Çdo lloj burimi tjetër të specifikuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi.

d) Përrjashtimet nga detyrimet e kësaj rregulloreje jepen bashkëngjitur lista I.

2. Kërkesat e legjislacionit duhet të zbatohen ndaj çdo burimi individual të rrezatimeve brenda një pajisjeje ose instalimi dhe ndaj pajisjes ose instalimit e parë në tërësi si një burim.

Neni 8

Justifikimi i praktikave

1. Të gjitha praktikrat ose burimet duhet të justifikohen duke marrë parasysh faktorët ekonomikë, socialë dhe faktorë të tjerë që lidhen me to.

2. Përrjashtim bëjnë praktikrat e mëposhtme, kur ato rezultojnë me një rritje, nëpërmjet shtimit të qëllimshëm të lëndëve radioaktive ose nëpërmjet aktivimit, në përdorimin e sendeve ose produkteve që lidhen me to:

a) praktika që përfshijnë ushqime, pije, kozmetikë ose sende dhe produkte që destinohen për ngrënie, thithje, që përdoren te njerëzit;

b) praktika që përfshijnë përdorimin në sasi të pakët të rrezatimeve dhe lëndëve radioaktive në sende si lodrat, bizhuteritë dhe zbukurimet personale.

Neni 9

Kufizimi i dozave

Ekspozimi normal i individëve duhet të kufizohet në mënyrë të tillë që doza totale efektive ose doza ekuivalente totale në inde dhe organe, e shkaktuar nga kombinimi i mundshëm i ekspozimeve nga praktika të autorizuara, të mos kalojë dozën kufi. Kufijtë e dozave nuk duhet të zbatohen në ekspozimet mjekësore nga praktika të autorizuara për një qëllim të caktuar. Kufijtë e dozave i bashkëngjiten kësaj rregulloreje, lista II.

Neni 10

Optimizimi i mbrojtjes dhe sigurisë

Në lidhje me ekspozimet nga çdo burim i veçantë brenda një praktike, mjekësore, mbrojtja, siguria dhe sigurimi duhet të optimizohen më qëllim që vlera e dozave individuale, numri i njerëzve të ekspozuar dhe mundësia e ndodhjes së ekspozimeve të mbahen në nivelet me të ulëtat që mund të arrihen në mënyrë të arsyeshme, duke mbajtur parasysh faktorët ekonomikë dhe socialë. Dozat kufi në procesin e optimizimit kalojnë në subjekt të dozave shtrënguese.

Neni 11 **Dozat shtrënguese**

1. Me përjashtim të ekspozimeve mjekësore, optimizimi i masave mbrojtëse dhe sigurisë të shoqëruara me burime të veçanta brenda një praktike, duhet të jetë objekt i dozave shtrënguese, të cilat:

- a) të mos tejkalojnë vlerat e miratuara nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi;
- b) të sigurojnë për çdo burim (duke përfshirë instalimet e trajtimit të mbetjeve radioaktive) që mund të çlirojnë lëndë radioaktive në mjedis, që efektet akumuluese të çdo shkarkimi vjetor nga burimi të shtrëngohen me qëllim që doza efektive vjetore për çdo individ, duke përfshirë dhe njerëzit që gjenden larg burimit ose brezat e ardhshëm, të mos ketë mundësi të tejkalojë dozën shtrënguese, duke mbajtur parasysh çlirimet akumuluese dhe ekspozimet që pritet të ndodhin edhe nga burime e praktika të tjera që janë nën kontroll.

Neni 12 **Ekspozimet**

1. Ekspozimet ndaj të cilave zbatohen kërkesat janë ekspozimi profesional, ekspozimi mjekësor dhe ekspozimi publik, si pasojë e çdo praktike ose burimi brenda praktikës, duke përfshirë si ekspozimet normale, emergjente dhe ato potenciale .

2. Ekspozimi ndaj burimeve natyrore normalisht duhet të konsiderohet si një situatë e ekspozimit kronik dhe kur është e nevojshme duhet të bëhet objekt i kërkesave për ndërhyrje nga ana e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimi .

3. Kërkesat e detajuara përcaktohen qartë në rregulloret për ekspozimet profesionale, ekspozimet mjekësore, ekspozimet publike si për ato potenciale, emergjente dhe normale.

Neni 13 **Licencimi**

1. Çdo person fizik a juridik, që ka për qëllim të ndërmarrë ndonjë nga veprimet e specifikuar te detyrimet e përgjithshme për praktikatat e burimet, duhet të paraqesë një njoftim me shkrim te zyra për mbrojtjen nga rrezatimet (ZMR) për veprimin që do të ndërmarrë.

2. Personi juridik ose fizik përgjegjës për çdo lloj burimi të hapur ose të mbyllur dhe për gjeneratorë të rrezatimit duhet të aplikojë te zyra për mbrojtjen nga rrezatimet për licencë. Çdo person fizik juridik që aplikon duhet të plotësojë kushtet që i kërkohen. Kushtet më specifike për licencimin jepen në rregulloret përkatëse.

3. Personat fizikë, juridikë të licencuar mbajnë përgjegjësinë kryesore për vendosjen dhe zbatimin e masave teknike dhe organizative që nevojiten për të realizuar mbrojtjen, sigurinë dhe sigurimin e burimeve për të cilat ata janë licencuar. Të licencuarit duhet t'i identifikojnë në mënyrë specifike individët përgjegjës për sigurimin e përmbushjes së standardeve.

Neni 14 **Çlirimi nga kontrollat**

Burimet që përmbajnë lëndë, materiale dhe objekte, brenda praktikave të njoftuara ose të autorizuara, çlirohen nga kërkesat e mëtejshme të standardeve, në rastin kur janë nën nivelet e çlirimit nga kontrolli, të miratuara nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi.

Neni 15 **Nivelet udhëzuese për ekspozimin mjekësor**

1. Nivelet udhëzuese për ekspozimin mjekësor, që duhet të përdoren nga personeli mjekësor kanë si qëllim:

- a) të jenë tregues të arsyeshëm të dozave për pacientët me përmasa normale;
- b) të përcaktohen nga organe profesionale përkatëse në konsultim me Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimi;
- c) të sigurojnë një udhëzim të praktikës së përshtatshme;
- d) të zbatohen me fleksibilitet për të lejuar ekspozime me të larta, nëse ato janë të nevojshme, dhe të justifikuara pas një gjykimi të saktë klinik;
- e) të rishikohen sa herë që ndodhin përmirësime të teknologjisë dhe teknikës.

Neni 16 **Sigurimi i cilësisë**

1. Programet e sigurimit të cilësisë duhet të vendosen me qëllim që të arrijnë:
 - a) plotësim adekuat të kërkesave specifike që lidhen me plotësimin e masave mbrojtëse, sigurisë dhe sigurimit;
 - b) shqyrtimin dhe vlerësimin e efektivitetit të masave të mbrojtjes, sigurisë dhe sigurimit nëpërmjet mekanizmave dhe procedurave të kontrollit të cilësisë.

Neni 17 **Masat për zvogëlimin e gabimeve njerëzore**

1. Për zvogëlimin e kontributit të gabimeve njerëzore, sa të jetë e mundur, në ndodhjen e aksidenteve dhe ngjarjeve të tjera që mund të çojnë në ekspozime shtesë, të merren masat e mëposhtme, të cilat sigurojnë që:
 - a) personeli nga i cili varet mbrojtja, siguria dhe sigurimi duhet të jetë i kualifikuar dhe i trajnuar;
 - b) ndjekjen e parimeve të qarta për projektimin e pajisjeve dhe procedurave vepruese, me qëllim që të favorizojnë përdorimin dhe veprimet e sigurta, për zvogëlimin e mundësisë që gabimet operative të çojnë në aksidente dhe për të reduktuar mundësinë e keqinterpretimit të indikacioneve në kushte normale dhe jonormale;
 - c) pajisjen me instrumente të përshtatshme, sisteme sigurie dhe kërkesa procedurale në mënyrë që të zvogëlohet sa më shumë që të jetë e mundur që gabimi njerëzor të çojë në ekspozim shtesë dhe të paqëllimshëm të punonjësve;
 - d) sigurimin e mjeteve dhe procedurave për kapjen e gabimeve njerëzore dhe për korrigjimin ose kompensimin e tyre;
 - e) lehtësimin e ndërhyrjes në rast defekti të sistemeve të sigurisë ose të masave të tjera mbrojtëse.

Neni 18 **Ekspertët e mbrojtjes nga rrezatimi**

1. Zbatimi i standardeve dhe sigurimi i këshillave bëhet nga ekspertët të kualifikuar që duhet të përcaktohen për qëllimet e mësipërme.
2. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi duhet të përcaktojë kritere të qarta për ekspertët e kualifikuar.

Neni 19 **Sigurimi i burimeve**

1. Burimet duhet të mbahen të sigurta për të parandaluar vjedhjen ose dëmtimin, duke siguruar që:
 - a) kontrolli i një burimi të mos quhet i mbaruar pa përmbushjen e kërkesave të sigurimit;
 - b) asnjë burim të mos transferohet, përveçse kur marrësi zotëron një autorizim të vlefshëm;
- dhe

c) hartimin e një inventari periodik të burimeve të lëvizshme në intervale të përshtatshme, për të konfirmuar që ato janë në vendin e caktuar dhe janë të sigurta.

Neni 20

Vlerësimi i sigurisë dhe sigurimit

1. Vlerësimet e sigurisë që lidhen me masat për mbrojtjen, sigurinë dhe sigurimin e burimeve që janë brenda praktikave duhet të bëhen në etapa të ndryshme, duke përfshirë vendosjen, projektimin, prodhimin, ndërtimin, montimin, futjen në punë, mirëmbajtjen dhe çmontimin në mënyrë që:

a) të identifikojë rrugët në të cilat mund të ndodhin ekspozimet normale dhe potenciale, duke mbajtur parasysh efektet e ngjarjeve të jashtme ndaj burimeve, si dhe ngjarje që përfshijnë direkt burimet dhe pajisjet e lidhura me të;

b) të përcaktojë vlerat e pritshme të ekspozimeve normale dhe me shtrirje të arsyeshme dhe praktike;

c) të vlerësojë cilësinë e masave mbrojtëse, sigurisë dhe sigurimit.

2. Për qëllimet e monitorimit dhe verifikimit të përmbushjes së standardeve, duhet të sigurohen pajisje të përshtatshme dhe të futen procedurat e verifikimit. Pajisjet duhet të mirëmbahen, testohen dhe duhet të kalibrohen çdo tre vjet dhe pas çdo riparimi.

Neni 21

Mbrojtja në thellësi

1. Për realizimin e mbrojtjes, sigurisë dhe sigurimit, në përputhje me vlerat dhe mundësinë e ekspozimeve potenciale, duhet të zbatohet një sistem shumështrësor (mbrojtja në thellësi) masash ndaj burimeve, për të bërë të mundur që dëmtimi i një shtrese të kompensohet ose të korrektohet nga shtresa pasardhëse me qëllim që:

a) të parandalojë aksidentet që mund të shkaktojnë ekspozim;

b) të lehtësojë pasojat nëse ndodh ndonjë aksident i tillë;

c) t'i rikthejë burimet në kushte të sigurta pas një aksidenti të tillë.

Neni 22

Ndërhyrje

1. Situatat e ndërhyrjes janë:

a) situatat emergjente të ekspozimit që kërkojnë veprime mbrojtëse për të zvogëluar ose shmangur ekspozimet e përkohshme, duke përfshirë:

i) aksidentet dhe emergjencat në të cilat duhet të aktivizohet plani i emergjencës;

ii) çdo situatë tjetër, ekspozimi të përkohshëm, e identifikuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi;

b) situatat e ekspozimit kronik që kërkojnë veprime rregulluese për të ulur ose shmangur ekspozimin kronik, duke përfshirë:

i) ekspozimin natyror, si p.sh. ekspozimet ndaj radonit në ndërtesa dhe në vendet e punës;

ii) ekspozimi ndaj mbetjeve radioaktive që rezultojnë nga e kaluara, si p.sh. ndotja radioaktive e shkaktuar nga aksidentet, pasi situata që kërkon veprime mbrojtëse ka përfunduar, ashtu si edhe nga drejtimi i praktikave dhe përdorimi i burimeve që nuk i janë nënshtruar sistemit të njoftimit dhe autorizimit;

iii) çdo situatë tjetër të ekspozimit kronik të përcaktuar nga KMR.

2. Ndërhyrja është e justifikuar vetëm kur mendohet që do të kryejë më shumë dobi se dëm në përputhje me faktorët ekonomikë, socialë dhe shëndetësorë.

3. Nivelet e optimizuara të ndërhyrjeve dhe nivelet e veprimit do të përcaktohen në planin për situatat e ndërhyrjes, në bazë të niveleve udhëzuese të dhëna, duke i ndryshuar në përputhje me kushtet kombëtare dhe lokale.

Neni 23

Kërkesat ndaj njoftimit

1. Subjekti i licencuar do të njoftojë Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimi dhe organizmat ndërhyrëse menjëherë sapo krijohet ose pritët që të krijohet një situatë që kërkon veprime ndërhyrëse mbrojtëse dhe do t'i informojë ata për:

- i) situatën që është zhvilluar ose që pritët që të zhvillohet;
- ii) masat e marra për mbrojtjen e punonjësve dhe popullatën; dhe
- iii) ekspozimet që kanë ndodhur ose që pritët të ndodhin.

Neni 24

Interpretimi i termave

Interpretimi i termave të përdorur në rregulloret dhe dokumentet për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese kryhet vetëm nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi. Asnjë interpretim tjetër që lidhet me rrezatimet jonizuese nuk është i vlefshëm.

LISTA I PËRJASHTIMET

KRITERET E PËRJASHTIMIT

I-1 Praktikrat dhe burimet brenda një praktike mund të përjashtohen nga kërkesat e standardeve, duke përfshirë ato për njoftim, regjistrim ose licencim, nëse Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet mendon që burimi përmbush kriteret e përjashtimit ose nivelet e përjashtimit të përcaktuar në këtë listë, ose nivele të tjera të përjashtimit të përcaktuara nga autoriteti rregullator në bazë të këtyre kriterëve përjashtuese. Përjashtimi nuk mund të bëhet shkak për të lejuar praktika që ndryshe nuk do të justifikoheshin.

I-2 Parimet e përgjithshme të përjashtimit janë:

- a) rreziku i rrezatimeve ndaj individëve i shkaktuar nga një praktikë ose burim i përjashtuar të jetë kaq i ulët sa që të mos shkaktojë shqetësime të karakterit rregullator;
- b) efekti radiologjik kolektiv i një praktike ose burimi të përjashtuar të jetë aq i ulët sa që të mos kërkojë kontroll në kushtet mbizotëruese;
- c) praktikrat dhe burimet e përjashtuara të jenë të sigurta në përmbajtjen e tyre dhe me skenarë me mundësi shumë të vogla, që çojnë në mungesa për përmbushjen e kriterëve në (a) dhe (b).

I-3 Një praktikë ose një burim brenda një praktike mund të përjashtohet pa konsiderata të mëtejshme që sigurojnë përmbushjen e kriterëve të mëposhtme në të gjitha situatat e shqyrtuara.

Doza efektive që pritët të merret nga çdo individ i publikut për shkak të praktikës ose burimit të përjashtuar është e rendit $10 \mu\text{Sv}$ ose më e vogël për një vit, dhe nëse doza kolektive e pritshme, për çdo individ të publikut e marrë gjatë një viti të zhvillimit të praktikës është jo më e madhe se 1 njeri Sv ose vlerësimi për optimizimin e mbrojtjes tregon që përjashtimi është zgjedhja optimale.

BURIMET E PËRJASHTUARA DHE NIVELET E PËRJASHTIMIT

I-4 Bazuar në kriteret e paragrafëve I-1 deri I-3, burimet dhe praktikrat e mëposhtme janë automatikisht të përjashtuara pa konsiderata të mëtejshme nga kërkesat e standardeve, duke përfshirë edhe ato për njoftim, regjistrim ose licencim:

- a) lëndët radioaktive për të cilat aktiviteti i përgjithshëm i një radionuklidi të dhënë në një instalim në çdo kohë ose përqendrimi i aktivitetit të përdorur në praktikë nuk i kalojnë nivelet e përjashtimit të dhëna në tabelën I-I të kësaj liste; dhe
- b) gjeneratorët e rrezatimeve të një lloji të miratuar nga autoriteti rregullator dhe çdo lloji tubi elektronik si p.sh. një tub i rrezeve katodike për nxjerrjen e figurave vizuale, duke siguruar që:
 - i) ato nuk shkaktojnë, në kushte normale pune, një fuqi doze ambientale ose një fuqi doze ekuivalente të drejtuar që nuk e kalon vlerën $1 \mu\text{Sv/orë}$ në largësinë 1 m nga çdo sipërfaqe e përdorshme e aparatit; ose

ii) energjia maksimale e rrezatimit të prodhuar nuk është më e lartë se 5 keV.

I-5 Përjashtim i kushtëzuar mund t'u jepet subjekteve të caktuara me kushtet e përcaktuara nga autoriteti rregullator, si kushti që lidhet me formën kimike ose fizike dhe përdorimi ose gruposja e mbetjeve radioaktive. Në veçanti, një përjashtim i tillë mund t'i jepet një aparati që përmban një lëndë radioaktive që nuk është i përjashtuar në kushtet e paragrafit I-4 (a), por që siguron:

a) se është një lloj i miratuar nga autoriteti rregullator;

b) lëndët radioaktive janë në formën e burimeve, në formë të mbyllur që parandalon në mënyrë efektive çdo kontakt me lëndën radioaktive ose rrjedhjen e saj me përjashtim të faktit që kjo nuk duhet të parandalojë përjashtimin e sasive të vogla të burimeve në formë të hapur siç janë ato që përdoren në radioimunose;

c) në kushte normale pune ai nuk shkakton një fuqi doze mjedisore ose një fuqi doze ekuivalente të drejtuar që nuk e kalon vlerën $1 \mu\text{Sv/orë}$ në largësinë 1 m nga çdo sipërfaqe e përdorshme e aparatit; dhe

d) kushtet e nevojshme për gruposje janë përcaktuar nga autoriteti rregullator.

I-6 Lëndët radioaktive nga një praktikë ose burim i autorizuar, çlirimi i të cilit në mjedis ka qenë i autorizuar, janë përjashtuar nga çdo kërkesë e re e njoftimit, e regjistrimit ose licencimit përderisa nuk është përcaktuar ndryshe nga autoriteti rregullator

LISTA I PËRJASHTIMET

TABELA I-I

NIVLELET E PËRJASHTIMIT: PËRQENDRIMET E AKTIVITETEVE DHE AKTIVITETET E PËRJASHTUARA [SHIH SHËNIMIN 36]

Nuklidi	Përqendrimi i aktivitetit (Bq/g)	Aktiviteti (Bq)
H-3	1 E+06	1 E+09
Be-7	1 E+03	1 E+07
C-14	1 E+04	1 E+07
O-15	1 E+02	1 E+09
F-18	1 E+01	1 E+06
Na-22	1 E+01	1 E+06
Na-24	1 E+01	1 E+05
Si-31	1 E+03	1 E+06
P-32	1 E+03	1 E+05
P-33	1 E+05	1 E+08
S-35	1 E+05	1 E+08
Cl-36	1 E+04	1 E+06
Cl-38	1 E+01	1 E+05
Ar-37	1 E+06	1 E+08
Ar-41	1 E+02	1 E+09
K-40	1 E+02	1 E+06
K-42	1 E+02	1 E+06
K-43	1 E+01	1 E+06
Ca-45	1 E+04	1 E+07
Ca-47	1 E+01	1 E+06
Sc-46	1 E+01	1 E+06
Sc-47	1 E+02	1 E+06
Sc-48	1 E+01	1 E+05
V-48	1 E+01	1 E+05
Cr-51	1 E+03	1 E+07

Mn-51	1 E+01	1 E+05
Mn-52	1 E+01	1 E+05
Mn-52m	1 E+01	1 E+05
Mn-53	1 E+04	1 E+09
Mn-54	1 E+01	1 E+06
Mn-56	1 E+01	1 E+05
Fe-52	1 E+01	1 E+06
Fe-55	1 E+04	1 E+06
Fe-59	1 E+01	1 E+06
Co-55	1 E+01	1 E+06
Co-56	1 E+01	1 E+05
Co-57	1 E+02	1 E+06
Co-58	1 E+01	1 E+06
Nuklidi	Përqendrimi i aktivitetit (Bq/g)	Aktiviteti (Bq)
Co-58m	1 E+04	1 E+07
Co-60	1 E+01	1 E+05
Co-60m	1 E+03	1 E+06
Co-61	1 E+02	1 E+06
Co-62m	1 E+01	1 E+05
Ni-59	1 E+04	1 E+08
Ni-63	1 E+05	1 E+08
Ni-65	1 E+01	1 E+06
Cu-64	1 E+02	1 E+06
Zn-65	1 E+01	1 E+06
Zn-69	1 E+04	1 E+06
Zn-69m	1 E+02	1 E+06
Ga-72	1 E+01	1 E+05
Ge-71	1 E+04	1 E+08
As-73	1 E+03	1 E+07
As-74	1 E+01	1 E+06
As-76	1 E+02	1 E+05
As-77	1 E+03	1 E+06
Se-75	1 E+02	1 E+06
Br-82	1 E+01	1 E+06
Kr-74	1 E+02	1 E+09
Kr-76	1 E+02	1 E+09
Kr-77	1 E+02	1 E+09
Kr-79	1 E+03	1 E+05
Kr-81	1 E+04	1 E+07
Kr-83m	1 E+05	1 E+12
Kr-85	1 E+05	1 E+04
Kr-85m	1 E+03	1 E+10
Kr-87	1 E+02	1 E+09
Kr-88	1 E+02	1 E+09
Rb-86	1 E+02	1 E+05
Sr-85	1 E+02	1 E+06
Sr-85m	1 E+02	1 E+07
Sr-87m	1 E+02	1 E+06
Sr-89	1 E+03	1 E+06
Sr-90*	1 E+02	1 E+04

Sr-91	1 E+01	1 E+05
Sr-92	1 E+01	1 E+06
Y-90	1 E+03	1 E+05
Y-91	1 E+03	1 E+06
Y-91m	1 E+02	1 E+06
Y-92	1 E+02	1 E+05
Y-93	1 E+02	1 E+05
Zr-93*	1 E+03	1 E+07
Nuklidi	Përqendrimi i aktivitetit (Bq/g)	Aktiviteti (Bq)
Zr-95	1 E+01	1 E+06
Zr-97*	1 E+01	1 E+05
Nb-93m	1 E+04	1 E+07
Nb-94	1 E+01	1 E+06
Nb-95	1 E+01	1 E+06
Nb-97	1 E+01	1 E+06
Nb-98	1 E+01	1 E+05
Mo-90	1 E+01	1 E+06
Mo-93	1 E+03	1 E+08
Mo-99	1 E+02	1 E+06
Mo-101	1 E+01	1 E+06
Tc-96	1 E+01	1 E+06
Tc-96m	1 E+03	1 E+07
Tc-97	1 E+03	1 E+08
Tc-97m	1 E+03	1 E+07
Tc-99	1 E+04	1 E+07
Tc-99m	1 E+02	1 E+07
Ru-97	1 E+02	1 E+07
Ru-103	1 E+02	1 E+06
Ru-105	1 E+01	1 E+06
Ru-106*	1 E+02	1 E+05
Rh-103m	1 E+04	1 E+08
Rh-105	1 E+02	1 E+07
Pd-103	1 E+03	1 E+08
Pd-109	1 E+03	1 E+06
Ag-105	1 E+02	1 E+06
Ag-110m	1 E+01	1 E+06
Ag-111	1 E+03	1 E+06
Cd-109	1 E+04	1 E+06
Cd-115	1 E+02	1 E+06
Cd-115m	1 E+03	1 E+06
In-111	1 E+02	1 E+06
In-113m	1 E+02	1 E+06
In-114m	1 E+02	1 E+06
In-115m	1 E+02	1 E+06
Sn-113	1 E+03	1 E+07
Sn-125	1 E+02	1 E+05
Sb-122	1 E+02	1 E+04
Sb-124	1 E+01	1 E+06
Sb-125	1 E+02	1 E+06
Te-123m	1 E+02	1 E+07

Te-125m	1 E+03	1 E+07
Te-127	1 E+03	1 E+06
Te-127m	1 E+03	1 E+07
Nuklidi	Përqendrimi i aktivitetit (Bq/g)	Aktiviteti (Bq)
Te-129	1 E+02	1 E+06
Te-129m	1 E+03	1 E+06
Te-131	1 E+02	1 E+05
Te-131m	1 E+01	1 E+06
Te-132	1 E+02	1 E+07
Te-133	1 E+01	1 E+05
Te-133m	1 E+01	1 E+05
Te-134	1 E+01	1 E+06
I-123	1 E+02	1 E+07
I-125	1 E+03	1 E+06
I-126	1 E+02	1 E+06
I-129	1 E+02	1 E+05
I-130	1 E+01	1 E+06
I-131	1 E+02	1 E+06
I-132	1 E+01	1 E+05
I-133	1 E+01	1 E+06
I-134	1 E+01	1 E+05
I-135	1 E+01	1 E+06
Xe131m	1 E+04	1 E+04
Xe-133	1 E+03	1 E+04
Xe-135	1 E+03	1 E+10
Cs-129	1 E+02	1 E+05
Cs-131	1 E+03	1 E+06
Cs-132	1 E+01	1 E+05
Cs-134m	1 E+03	1 E+05
Cs-134	1 E+01	1 E+04
Cs-135	1 E+04	1 E+07
Cs-136	1 E+01	1 E+05
Cs-137*	1 E+01	1 E+04
Cs-138	1 E+01	1 E+04
Ba-131	1 E+02	1 E+06
Ba-140*	1 E+01	1 E+05
La-140	1 E+01	1 E+05
Ce-139	1 E+02	1 E+06
Ce-141	1 E+02	1 E+07
Ce-143	1 E+02	1 E+06
Ce-144*	1 E+02	1 E+05
Pr-142	1 E+02	1 E+05
Pr-143	1 E+04	1 E+06
Nd-147	1 E+02	1 E+06
Nd-149	1 E+02	1 E+06
Pm-147	1 E+04	1 E+07
Pm-149	1 E+03	1 E+06
Sm-151	1 E+04	1 E+08

Nuklidi	Përqendrimi i aktivitetit (Bq/g)	Aktiviteti (Bq)
Sm-153	1 E+02	1 E+06
Eu-152	1E+01	1 E+06
Eu-152m	1 E+02	1 E+06
Eu-154	1 E+01	1 E+06
Eu-155	1 E+02	1 E+07
Gd-153	1 E+02	1 E+07
Gd-159	1 E+03	1 E+06
Tb-160	1 E+01	1 E+06
Dy-165	1 E+03	1 E+06
Dy-166	1 E+03	1 E+06
Ho-166	1 E+03	1 E+05
Er-169	1 E+04	1 E+07
Er-171	1 E+02	1 E+06
Tm-170	1 E+03	1 E+06
Tm-171	1 E+04	1 E+08
Yb-175	1 E+03	1 E+07
Lu-177	1 E+03	1 E+07
Hf-181	1 E+01	1 E+06
Ta-182	1 E+01	1 E+04
W-181	1 E+03	1 E+07
W-185	1 E+04	1 E+07
W-187	1 E+02	1 E+06
Re-186	1 E+03	1 E+06
Re-188	1 E+02	1 E+05
Os-185	1 E+01	1 E+06
Os-191	1 E+02	1 E+07
Os-191m	1 E+03	1 E+07
Os-193	1 E+02	1 E+06
Ir-190	1 E+01	1 E+06
Ir-192	1 E+01	1 E+04
Ir-194	1 E+02	1 E+05
Pt-191	1 E+02	1 E+06
Pt-193m	1 E+03	1 E+07
Pt-197	1 E+03	1 E+06
Pt-197m	1 E+02	1 E+06
Au-198	1 E+02	1 E+06
Au-199	1 E+02	1 E+06
Hg-197	1 E+02	1 E+07
Hg197m	1 E+02	1 E+06
Hg-203	1 E+02	1 E+05
Tl-200	1 E+01	1 E+06
Tl-201	1 E+02	1 E+06
Tl-202	1 E+02	1 E+06
Tl-204	1 E+04	1 E+04

Nuklidi	Përqendrimi i aktivitetit (Bq/g)	Aktiviteti (Bq)
Pb-203	1 E+02	1 E+06
Pb-210*	1 E+01	1 E+04
Pb-212*	1 E+01	1 E+05
Bi-206	1 E+01	1 E+05
Bi-207	1 E+01	1 E+06
Bi-210	1 E+03	1 E+06
Bi-212*	1 E+01	1 E+05
Po-203	1 E+01	1 E+06
Po-205	1 E+01	1 E+06
Po-207	1 E+01	1 E+06
Po-210	1 E+01	1 E+04
At-211	1 E+03	1 E+07
Rn-220*	1 E+04	1 E+07
Rn-222*	1 E+01	1 E+08
Ra-223*	1 E+02	1 E+05
Ra-224*	1 E+01	1 E+05
Ra-225	1 E+02	1 E+05
Ra-226*	1 E+01	1 E+04
Ra-227	1 E+02	1 E+06
Ra-228*	1 E+01	1 E+05
Ac-228	1 E+01	1 E+06
Th-226*	1 E+03	1 E+07
Th-227	1 E+01	1 E+04
Th-228*	1 E+00	1 E+04
Th-229*	1 E+00	1 E+03
Th-230	1 E+00	1 E+04
Th-231	1 E+03	1 E+07
Th-nat (incl.Th-232)	1 E+00	1 E+03
Th-234*	1 E+03	1 E+05
Pa-230	1 E+01	1 E+06
Pa-231	1 E+00	1 E+03
Pa-233	1 E+02	1 E+07
U-230*	1 E+01	1 E+05
U-231	1 E+02	1 E+07
U-232*	1 E+00	1 E+03
U-233	1 E+01	1 E+04
U-234	1 E+01	1 E+04
U-235*	1 E+01	1 E+04
U-236	1 E+01	1 E+04
U-237	1 E+02	1 E+06
U-238*	1 E+01	1 E+04
U-nat	1 E+00	1 E+03
U-239	1 E+02	1 E+06
U-240	1 E+03	1 E+07

Nuklidi	Përqendrimi i aktivitetit (Bq/g)	Aktiviteti (Bq)
U-240*	1 E+01	1 E+06
Np-237*	1 E+00	1 E+03
Np-239	1 E+02	1 E+07
Np-240	1 E+01	1 E+06
Pu-234	1 E+02	1 E+07
Pu-235	1 E+02	1 E+07
Pu-236	1 E+01	1 E+04
Pu-237	1 E+03	1 E+07
Pu-238	1 E+00	1 E+04
Pu-239	1 E+00	1 E+04
Pu-240	1 E+00	1 E+03
Pu-241	1 E+02	1 E+05
Pu-242	1 E+00	1 E+04
Pu-243	1 E+03	1 E+07
Pu-244	1 E+00	1 E+04
Am-241	1 E+00	1 E+04
Am-242	1 E+03	1 E+06
Am-242m*	1 E+00	1 E+04
Am243*	1 E+00	1 E+03
Cm-242	1 E+02	1 E+05
Cm-243	1 E+00	1 E+04
Cm-244	1 E+01	1 E+04
Cm-245	1 E+00	1 E+03
Cm-246	1 E+00	1 E+03
Cm-247	1 E+00	1 E+04
Cm-248	1 E+00	1 E+03
Bk-249	1 E+03	1 E+06
Cf-246	1 E+03	1 E+06
Cf-248	1 E+01	1 E+04
Cf-249	1 E+00	1 E+03
Cf-250	1 E+01	1 E+04
Cf-251	1 E+00	1 E+03
Cf-252	1 E+01	1 E+04
Cf-253	1 E+02	1 E+05
Cf-254	1 E+00	1 E+03
Es-253	1 E+02	1 E+05
Es-254	1 E+01	1 E+04
Es-254m	1 E+02	1 E+06
Fm-254	1 E+04	1 E+07
Fm-255	1 E+03	1 E+06

Radiobërthamat prindër dhe familja e tyre, në të cilën janë në ekulibër, janë të listuara në vazhdim:

Sr-90 Y-90

Zr-93 Nb-93m

Zr-97 Nb-97

Ru-106 Rh-106

Cs-137Ba-137m

Ba-140La-140

Ce-134La-134

Ce-144Pr-144

Pb-210Bi-210, Po-210
 Pb-212Bi-212, Tl-208 (0.36), Po-212 (0.64)
 Bi-212 Tl-208 (0.36), Po-212 (0.64)
 Rn-220 Po-216
 Rn-222 Po-218, Pb-214, Bi-214, Po-214
 Ra-223Rn-219, Po-215, Pb-211, Bi-211, Tl-207
 Ra-224Rn-220, Po-216, Pb-212, Bi-212, Tl-208(0.36), Po-212(0.64)
 Ra-226Rn-222, Po-218, Pb-214, Bi-214, Po-214, Pb-210, Bi-210, Po-210
 Ra-228Ac-228
 Th-226Ra-222, Rn-218, Po-214
 Th-228Ra-224, Rn-220, Po-216, Pb-212, Bi-212, Tl-208 (0.36), Po-212 (0.64)
 Th-229Ra-225, Ac-225, Fr-221, At-217, Bi-213, Po-213, Pb-209
 Th-nat Ra-228, Ac-228, Th-228, Ra-224, Rn-220, Po-216, Pb-212, Bi-212, Tl-208 (0.36), Po-212 (0.64)
 Th-234Pa-234m
 U-230 Th-226, Ra-222, Rn-218, Po-214
 U-232 Th-228, Ra-224, Rn-220, Po-216, Pb-212, Bi-212, Tl-208 (0.36), Po-212 (0.64)
 U-235 Th-231
 U-238 Th-234, Pa-234m
 U-nat Th-234, Pa-234m, U-234, Th-230, Ra-226, Rn-222, Po-218, Pb-214, Bi-214, Po-214, Pb-210, Bi-210, Po-210
 U-240 Np-240m
 Np-237 Pa-233
 Am-242m Am-242
 Am-243 Np-239

LISTA II KUFIJTË E DOZAVE

II-1 Kufijtë e dozave të përcaktuara në këtë listë zbatohen në ekspozimet që u takojnë praktikave, me përjashtim të ekspozimeve mjekësore dhe të ekspozimeve nga burimet natyrore, që nuk janë nën përgjegjësinë e palëve kryesore të standardeve.

II-2 Kufijtë e dozave nuk lidhen me kontrollin e ekspozimeve potenciale.

II-3 Kufijtë e dozave nuk lidhen me vendimet se kur do të ndërmerret një ndërhyrje, por punonjësit që do të ndërmarrin një ndërhyrje duhet të jenë subjekt i kërkesave përkatëse të një shtojce të veçantë .

EKSPOZIMI PROFESIONAL

II-4 Ekspozimi profesional i çdo punonjësi duhet të jetë i kontrolluar që kufijtë e mëposhtëm të mos tejkalojnë:

- a) një dozë efektive prej 20 mSv në vit e mesatarizuar për pesë vite të njëpasnjëshme;
- b) një dozë efektive prej 50 mSv në një vit të vetëm;
- c) një dozë ekuivalente në kristalin prej 150 mSv në vit; dhe
- d) një dozë ekuivalente në ekstremitete (duar dhe këmbë) ose në lëkurë prej 500 mSv në vit.

II-5 Për nxënësit e moshës 16 deri 18 vjeç, që janë në proces trajnimi për t'u punësuar në punë që përfshijnë ekspozime ndaj rrezatimeve dhe për studentët e moshës 16 deri 18 vjeç që duan të përdorin burimet gjatë studimeve të tyre, ekspozimi profesional duhet të jetë i kontrolluar që kufijtë e mëposhtëm të mos të tejkalojnë:

- a) një dozë efektive prej 6 mSv në vit;
- b) një dozë ekuivalente në kristalin prej 50 mSv në vit; dhe
- c) një dozë ekuivalente në ekstremitete ose në lëkurë prej 150 mSv në vit.

EKSPOZIMI PUBLIK

Kufijtë e dozave

II-6 Doza mesatare e vlerësuar për një grup kritik njerëzish të popullatës që lidhen me një praktikë nuk duhet të tejkalojë kufijtë e mëposhtëm:

a) një dozë vjetore prej 1 mSv në vit;

b) në rrethana të posaçme, një dozë efektive deri në 5 mSv në një vit të vetëm duke siguruar që doza mesatare e pesë viteve të njëpasnjëshme të mos kalojë 1 mSv në vit;

c) një dozë ekuivalente në kristalinë prej 15 mSv në vit; dhe

d) një dozë ekuivalente në lëkurë prej 50 mSv në vit.

Kufizimi i dozës për shoqëruesit dhe vizitorët

II-7 Kufijtë e dozave të vendosura në këtë pjesë nuk do të zbatohen për shoqëruesit e pacientëve, d.m.th. për individët që ekspozohen duke e ditur paraprakisht, ndërkohë që janë duke ndihmuar vullnetarisht (ndryshe nga profesioni ose punësimi i tyre) në përkujdesin, mbështetjen, dhe komfortin e pacientëve që kanë kaluar një diagnostikim ose trajtim mjekësor ose ndaj vizitorëve të këtyre pacientëve. Megjithatë doza e çdokujt nga shoqëruesit ose vizitorëve të pacientëve duhet të jetë e kufizuar në mënyrë që të ketë pak gjasa që mund të kalojë 5 mSv gjatë periodës së ekzaminimit diagnostik ose trajtimit të pacientit. Doza e fëmijëve që vizitojnë pacientët që kanë marrë lëndë radioaktive duhet të kufizohet gjithashtu në më pak se 1 mSv.

UDHËZIM

Nr.2, datë 29.6.2010

PËR DOKUMENTACIONIN E DOMOSDOSHËM PËR TË KËRKUAR LEJE MJEDISORE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 8990, datë 23.1.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.249, datë 24.4.2003 “Për miratimin e dokumentacionit për leje mjedisore dhe të elementeve të lejes mjedisore”,

UDHËZOJ:

1. Për t’u pajisur me leje mjedisore për veprimtaritë me ndikim në mjedis, personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, përgatisin dokumentet që kërkohen nga ligji “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.249, datë 24.4.2003 “Për miratimin e dokumentacionit për leje mjedisore dhe të elementeve të lejes mjedisore”.

2. Dokumentet për t’u pajisur me leje mjedisore konsistojnë në:

2.1 Kërkesën nga propozuesi, për t’u pajisur me leje mjedisore, për projektin apo veprimtarinë që do të ushtrohet drejtuar Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL). Kërkesa përmban informacionin e formularit përkatës së Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe plotësohet pranë QKL-së në momentin e aplikimit për leje mjedisi.

2.2 Dokumentacionin ligjor që përbëhet nga:

a) Fotokopje e noteruar e regjistrimit të biznesit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2.3 Dokumentacioni teknik (përshkrimi i aktivitetit, skica, harta etj.) që përbëhen nga:

a) Karakteristikat e projektit:

i) përshkrimi i teknologjisë, proceseve kryesore, kapaciteti, lëndët e para, energjia, lëndët ndihmëse, produktet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare;

ii) program pune për ndërtimin dhe shfrytëzimin;

iii) aktivitete të tjera që mund të kërkohen si pasojë e projektit (p.sh. rrugë të reja, sigurim i ujit të pijshëm etj.).

b) Vendndodhja e projektit:

i) planimetria me kufijtë hapësinorë të projektit;

ii) harta dhe fotografi që tregojnë vendndodhjen e projektit;

iii) planet ekzistuese të përdorimit të territorit ku zhvillohet projekti.

c) Raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis të hartuar nga ekspertë të certifikuar e të përzgjedhur nga kërkuesi i lejes mjedisore. Raportet e VNM-së të firmosen dhe vulosen nga hartuesit, si dhe të jepen të dhënat e licencës së ekspertëve të mjedisit të certifikuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (emrin, numrin e regjistrimit, datën e miratimit dhe numrin e vendimit të certifikatës).

d) Informacion me të dhëna të konsultimit me publikun dhe palët e interesuara. Bashkëngjitur informacionit të jenë procesverbale të takimeve, materialet e prezantuara, lista e personave të pranishëm, foto, që provojnë komunikimet e kërkuesit me publikun e zonës.

e) Deklaratë e përgatitur nga kërkuesi, ku evidentohen kërkesat apo pretendimet e paraqitura nga publiku, OJF-të lokale (OJF-të që veprojnë në nivel kombëtar për projekte kombëtare), përfaqësues të pushtetit vendor, apo palë të tjera të interesuara të ngritura gjatë prezantimit të veprimtarisë në kuadër të konsultimeve me publikun, si dhe sugjerimet dhe masat që do të merren parasysh nga subjekti.

f) Plani i rehabilitimit për veprimtaritë që shfrytëzojnë burimet minerare (karrierat lumore dhe zhuret). Plani i rehabilitimit hartohet sipas kërkesave të vendimit nr.3, datë 21.6.2006 të Këshillit Kombëtar të Ujit “Për rehabilitimin e shtretërve dhe të brigjeve të lumenjve, të dëmtuara nga shfrytëzimi i inerteve”, si dhe udhëzimit nr.3, datë 17.5.2006 “Për planet e rehabilitimit të sipërfaqeve të dëmtuara nga guroret”.

g) Plani i përballimit të emergjencave për veprimtaritë që përdorin, prodhojnë dhe magazinonë (depozitim) lëndë të rrezikshme për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve (si karburantet) apo substancat dhe preparatet e përshkruara në nenin 5 të ligjit nr.9108, datë 17.7.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”. Plani i përballimit të emergjencave të përgatitet sipas dispozitave të ligjit “Për emergjencat civile”.

h) Përmbledhjen joteknike (në gjuhë dhe terminologji lehtësisht të kuptueshme) të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili përmban informacion të përmbledhur për çdo çështje të trajtuar në raportin e VNM-së. Për lehtësi praktike dokumenti duhet të dorëzohet edhe elektronikisht në format PDF.

2.4 Vendimin/mendimin e këshillit të bashkisë apo komunës për ushtrimin e veprimtarisë në territorin e tyre.

2.5 Faturën e pagesës së tarifës së shërbimit për lejen mjedisore sipas përcaktimeve në udhëzimin përkatës.

3. Ky udhëzim duhet t’u shpjegohet kërkuesve të lejes mjedisore dhe t’u vihet në dispozicion që të përgatisin saktë dhe në kohë sa më të shkurtër dokumentet për të kërkuar leje mjedisore.

4. Për ndjekjen e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, udhëzim nr.1, datë 7.1.2008 “Për dokumentacionin e domosdoshëm për të kërkuar leje mjedisore”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Fatmir Mediu

UDHËZIM
Nr.26, datë 27.7.2010

**PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR.7, DATË 16.6.2003 “PËR AKCIZAT NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.7, datë 16.6.2003 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pas kreut XVI, shtohet kreu XVI/1 me këtë përmbajtje:

“XVI/1 Akcizat për ambalazhet e plastikës, ambalazhet e qelqit dhe ambalazhi i përzier
Në rastin e importimit

Për qëllim të këtij udhëzimi dhe në zbatim të ligjit nr.10 286, datë 3.6.2010 “Për disa shtesa në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar:

a) “Ambalazh” është çdo material paketues që shërben për paketimin e produkteve, i cili mund ta mbulojë tërësisht ose pjesërisht atë. Ai e mbron atë nga ndotja, infeksionet, si dhe nga ndikimet që ulin cilësinë dhe/ose vlerën e tij dhe e bën të përshtatshëm për transport, tregtim e përdorim. Një ambalazh mund të përmbajë disa njësi ose tipa ambalazhesh.

b) “Ambalazh plastik” është ambalazhi, në të cilin lloji i materialit të përdorur klasifikohet në kapitullin 39 të nomenklaturës së kombinuar të mallrave dhe zë të paktën 51% të masës së përgjithshme të ambalazhit.

c) “Ambalazh qelqi” është ambalazhi, në të cilin lloji i materialit të përdorur klasifikohet në kapitullin 70 të nomenklaturës së kombinuar të mallrave dhe zë të paktën 80% të masës së përgjithshme të ambalazhit.

d) “Ambalazh i përzier” është ambalazhi, në të cilin llojet e materialeve të përdorura klasifikohen në kapitujt 39 dhe/ose 70 të nomenklaturës së kombinuar të mallrave dhe zënë të paktën 20% të masës së përgjithshme të ambalazhit.

Importuesi duhet të marrë masa që vetë, apo nëpërmjet kompanisë prodhuese apo eksportuese, të bëjë ndarjen e llojeve të ambalazhit të produkteve të importuara, për qëllimet e aplikimit të akcizës. Në rast se nga ndarja rezulton që produktet përbërëse të ambalazhit sipas përkufizimit kategorizohen në germa “b”, “c” apo “d”, atëherë importuesi është i detyruar të deklarojë akcizë në deklarinë e tij dhe ta paguajë atë. Deklarimi i ambalazhit në DAV, në import bëhet në nivel artikulli.

Kur për të njëjtin artikull, ka ambalazhe të ndryshme sipas kategorizimit të mësipërm, detyrimisht në DAV do të bëhet deklarimi i ndarë për artikujt me kod tarifor të njëjtë, por me ambalazh të ndryshëm.

Shembull 1

Në rast se brenda së njëjtës ngarkesë rezulton të jetë importuar birrë e ambalazhuar në shishe qelqi me tapa metalike, të vendosura në kuti kartoni dhe gjithashtu birrë e ambalazhuar në fuçi metalike, në të njëjtin DAV, importuesi duhet ta deklarojë veçmas birrën e vendosur në shishe qelqi dhe veçmas birrën e vendosur në fuçi metalike, pavarësisht faktit që birra klasifikohet në të dy rastet në të njëjtin kod tarifor. Sipas këtij deklarimi, rezulton se masa e shisheve të qelqit, në sasinë totale të ambalazhit (shishe qelqi+tapa metalike+kutitë e kartonit, ku shisheet e qelqit janë vendosur=diferenca ndërmjet peshës bruto (kuadrati 35) dhe peshës neto (kuadrati 38) të DAV-it), vetëm për birrën në shishe është mbi 80% e masës totale të ambalazhit. Në këtë rast, ambalazhi do të trajtohet si ambalazh qelqi. Akciza do të aplikohet mbi të gjithë ambalazhin (diferenca ndërmjet peshës bruto dhe peshës neto).

Për birrën e vendosur në fuçi, nuk do të paguhet akcizë për ambalazhin.

Shembull 2

Në rast se brenda së njëjtës ngarkesë rezulton të jetë importuar vaj ushqimor në shishe qelqi me tapë metalike, të vendosura në kuti kartoni dhe gjithashtu vaj ushqimor në shishe plastike me tapë plastike, përsëri të vendosura në kuti kartoni, ambalazhi, për qëllime të aplikimit të nivelit të akcizës, nuk do të konsiderohet si ambalazh i përzier. Në këtë rast, në të njëjtin DAV, importuesi duhet të deklarojë veçmas vajin ushqimor të vendosur në shishe qelqi dhe kuti kartoni dhe veçmas vajin ushqimor të vendosur në shishe plastike dhe kuti kartoni, pavarësisht faktit që vaji ushqimor klasifikohet në të dy rastet në të njëjtin kod tarifor. Sipas këtij deklarimi, masa e shisheve të qelqit, në sasinë totale të ambalazhit (shishe qelqi+tapë metalike+kutitë e kartonit, ku shisheet e qelqit janë vendosur=diferenca ndërmjet peshës bruto (kuadrati 35) dhe peshës neto (kuadrat 38) të DAV-it), vetëm për vajin ushqimor të vendosur në shishe qelqi, rezulton mbi 80% e masës totale të ambalazhit, ndaj dhe ambalazhi do të trajtohet si ambalazh qelqi. Akciza do të aplikohet mbi të gjithë ambalazhin (diferenca ndërmjet peshës bruto dhe peshës neto).

Për vajin ushqimor të vendosur në shishe plastike dhe kuti kartoni, në rast se masa e shisheve plastike+tapat, e kalon 51% të masës totale të ambalazhit (diferenca ndërmjet peshës bruto dhe peshës neto=masa e shisheve plastike+masën e tapave plastike+masën e kutive të kartonit, ku këto shishe plastike janë vendosur) do të paguhet akcizë për ambalazhin që në këtë rast klasifikohet si ambalazh plastik. Akciza do të aplikohet mbi të gjithë ambalazhin (diferenca ndërmjet peshës bruto dhe peshës neto).

Në rast sa masa e shisheve plastike+tapat, nuk e kalon 51% të masës totale të ambalazhit, por e kalon 20% (diferenca ndërmjet peshës bruto dhe peshës neto=masa e shisheve plastike+masën e tapave+masën e kutive të kartonit, ku këto shishe plastike janë vendosur), do të paguhet akcizë për ambalazhin që në këtë rast klasifikohet si ambalazh i përzier. Akciza do të aplikohet mbi të gjithë ambalazhin (diferenca ndërmjet peshës bruto dhe peshës neto).

Shembull 3 (pika “b”)

Në rast të importimit të pijeve freskuese në shishe plastike, ku masa e ambalazhit plastik zë 51% të masës totale të ambalazhit (diferenca ndërmjet peshës bruto (kuadrati 35) dhe peshës neto (kuadrati 38) të DAV-it të deklaruar në import), ambalazhi do të konsiderohet si ambalazh plastik për qëllime të aplikimit të nivelit të akcizës. Akciza do të aplikohet mbi të gjithë ambalazhin (diferenca ndërmjet peshës bruto dhe peshës neto).

Shembull 4 (pika “c”)

Në rast të importimit të pijeve freskuese në shishe qelqi, ku masa e ambalazhit të qelqit zë 80% të masës totale të ambalazhit (diferenca ndërmjet peshës bruto (kuadrati 35) dhe peshës neto (kuadrati 38) të DAV-it të deklaruar në import), ambalazhi do të konsiderohet si ambalazh qelqi për qëllime të aplikimit të nivelit të akcizës. Akciza do të aplikohet mbi të gjithë ambalazhin (diferenca ndërmjet peshës bruto dhe peshës neto).

Shembull 5 (pika “d”)

Në rast të importimit të cigareve të vendosura në paketa letre/kartoni të mbyllura/veshura me plastmasë dhe të paketuara/vendosura në steka letre/kartoni, gjithashtu të mbyllura/veshura me plastmasë, të gjitha të vendosura në koli kartoni mbi paleta të mbështjella me plastmasë, ku masa e përgjithshme e plastmasit zë më pak se 20% të masës totale të ambalazhit (diferenca ndërmjet peshës bruto (kuadrati 35) dhe peshës neto (kuadrati 38) të DAV-it, të deklaruar në import), nuk aplikohet akcizë për mbështjelljen me plastmasë të paketave dhe stekave të cigareve.

Në rast se masa totale e ndonjërit lloj të ambalazhit të përdorur (sipas klasifikimit të tij në nomenklaturën e kombinuar të mallrave në kapituj 39 ose 70), është brenda limiteve të cilat mundësojnë klasifikimin e tyre si ambalazhe plastike apo qelqi, ato do të konsiderohen të tilla dhe jo ambalazh i përzier.

Shembull 6 (pika “d”)

Në rast të importimit të medikamenteve me lloje të ndryshme ambalazhi (plastik, qelq, karton, fletë alumini etj.) brenda së njëjtës ngarkesë, ku masa totale e ambalazhit të qelqit dhe/ose plastikës, zë më shumë se 20% të masës totale të ambalazhit (diferenca ndërmjet peshës bruto (kuadrati 35) dhe peshës neto (kuadrati 38) të DAV-it të deklaruar në import), por ambalazhi i qelqit

në veçanti zë më tepër se 80% e masës totale të ambalazhit, ambalazhi nuk do të konsiderohet si ambalazh i përzier për qëllime të aplikimit të nivelit të akcizës, por si ambalazh qelqi. Akciza do të aplikohet mbi të gjithë ambalazhin (diferenca ndërmjet peshës bruto dhe peshës neto).

Në të gjitha rastet, niveli përkatës i akcizës do të aplikohet ndaj masës totale të ambalazhit sipas kategorizimit të tij (diferencës ndërmjet peshës bruto (kuadrati 35) dhe peshës neto (kuadrati 38) të DAV-it në import.

Akciza në import do të aplikohet si për ambalazhet bosh të importuara, apo dhe në rastet e importimit të tyre bashkë me produktin, pavarësisht rasteve kur për efekte të klasifikimit tarifor, kur importohen me produktin, ambalazhet klasifikohen në të njëjtin kod tarifor me të.

Shembull 7

Në rast të importimit të birrës me shishe, shishja e birrës klasifikohet në kodin e birrës (kreu 2203 i NKM), ndërsa kur importohen veçmas (shishe boshe birre) ato klasifikohen sipas kodeve përkatëse të kapitullit 70.

Në rastet kur për një gamë të produkteve, të cilat paguajnë akcizë në import (p.sh. birra, vera etj.), por që mund të jenë të ambalazuara (në ambalazh qelqi, plastik apo të përzier) do të aplikohet dy herë akcizë: një herë për produktin dhe një herë për ambalazhin.

Akciza e paguar në import për ambalazhet e përcaktuara në ligj, do të pasqyrohet si zë më vete në kuadratin 47 të DAV-it, me emërtimin (kodifikimin) A02.

Në rastin e prodhimit vendas

1. Në rastet kur personat juridikë apo fizikë, prodhues të mallrave që kërkojnë ambalazh plastik, qelqi, të përzier, e prodhojnë vetë ambalazhin, akciza për ambalazhet do të paguhet në momentin e shitjes së mallrave, me faturë tatimore. Për efekt pagese, akcize të ambalazhit në shitjen e mallrave, subjekti prodhues do të ndajë në faturën tatimore, çdo shitje të mallrave sipas kapacitetit mbajtës të ambalazhit.

P.sh. kur subjekti prodhon mallra të ambalazuara në ambalazh 0,250 litra, 0,5 litra, 1,5 litra etj. (për mallrat e akcizës, ambalazhe me kapacitet mbajtës deri 5 litra), në faturën tatimore të shitjes së këtyre mallrave, ambalazhet me litrazhe të ndryshme do të faturohen veçmas.

2. Në rastet kur personat juridikë apo fizikë, prodhues të mallrave që kërkojnë ambalazh plastik, qelqi, të përzier, furnizohen nga subjekte që importojnë apo prodhojnë këto ambalazhe, kërkojnë nga prodhuesi apo importuesi, krahas faturës tatimore, dhe pagesën e akcizës në organet tatimore apo doganore.

3. Në rastet kur personat juridikë apo fizikë, prodhues të mallrave që kërkojnë ambalazh plastik, qelqi, të përzier, e prodhojnë vetë ambalazhin dhe e shesin atë për të tretë, do të paguajnë akcizë për sasinë e shitur me faturë tatimore.

4. Çdo person juridik apo fizik, prodhues i ambalazheve plastike, qelqi, të përziara, boshe për prodhimin e vet, si dhe çdo importues apo prodhues i ambalazheve boshe, në fund të çdo muaji do të deklarojnë stokun në organin tatimor ku është i regjistruar. Në rast të kundërt, organet tatimore do të llogarisin akcizën e këtyre ambalazheve për të gjitha shitjet e kryera për çdo muaj.

5. Çdo person juridik apo fizik, prodhues i ambalazheve plastike, qelqi, të përziara, boshe për prodhimin e vet, si dhe çdo importues apo prodhues i ambalazheve boshe, me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, do të deklarojë peshën e çdo ambalazhi, kjo për të bërë llogaritjen e akcizës së ambalazheve në kg, sipas shkallës tatimore të miratuar në shtojcën 1 të ligjit nr.10 286, datë 3.6.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

KËRKESË
Nr.2500/2, datë 30.7.2010

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qukës-Qafë-Ploç (loti I).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.872, datë 12.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik””, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen e titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Ky publikim bëhet vetëm për pasurinë e llojit: tokë, arë, truall kultura bujqësore dhe drufrutorë.

Për të gjitha pasuritë, për të cilat është bërë shënimi “Rikonfirmim”, do të kërkohet rikonfirmim pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Librazhd, për arsye se ka të dhëna të paplota në konfirmimin e dhënë.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 4 073 128 (katër milionë e shtatëdhjetë e tre mijë e njëqind e njëzet e tetë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE
DREJTORIA E SHPRONESIMEVE

LISTA EMERORE E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NE SEGMENTIN RRUGOR
"KUKES-QAFE PLOÇE" LOTI I

Nr	Emri	Atesia	Mbiemri	Z.K.	Numri i Pasurise	Lloji i Pas.	Sip. m2	Toke Are		Toke Truall		Kult. Bujq Drufutore (Leke)	SHUMA TOTALE (Leke)	Shemime
								Çmimi (tek/m2)	Shuma (Leke)	Çmimi (tek/m2)	Shuma (Leke)			
Fshati Qukes-Shkumbin Komuna Qukes Z.K. 3120														
1	"Albania Tabak"			3120	443/17	Truall	92			847	77924		77924	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Agim Sali	Leka		3120	443/10	Are	1200	149	178800			65100	243900	Konfirmuar nga ZVRPP
Fshati Berzeshte Komuna Qukes Z.K. 1169														
3	Fetah Xhevat		Biloshmi	1169	1088/5	Are	1920	184	353280				353280	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Vladimir Gani		Bardho	1169	1088/3	Are	600	184	110400				110400	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Avni Sabri		Kogoli	1169	1088/4	Are	950	184	174800				174800	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Gani		Zogolli	1169	1059/1	Are	390	184	71760				71760	Konfirmuar nga ZVRPP
7	I Pidentifikuar			1169	1059/2	Are	200	184	36800				36800	Rikonfirmim
8	Shetfet		Leka	1169	1058/4	Are	260	184	47840			17860	65700	Konfirmuar nga ZVRPP
9	Petref		Leka	1169	1058/2	Are	31	184	5704			5020	10724	Konfirmuar nga ZVRPP
10	Barbuqe		Cerna	1169	1067/2	Are	45	184	8280			10040	18320	Konfirmuar nga ZVRPP
11	Shahe		Dashballa	1169	1069/3	Are	310	184	57040			23040	80080	Konfirmuar nga ZVRPP
12	Pellumb		Leka	1169	1064/1	Are	80	184	14720				14720	Konfirmuar nga ZVRPP
13	Limani	Muharrem	Dashballa	1169	1069/2	Are	240	184	44160			15450	59610	Konfirmuar nga ZVRPP
Fshati Karkavec Komuna Qukes Z.K. 2096														
14	Haki	Maksut		2096	232/1	Are	1145	217	248465			52440	300905	Konfirmuar nga ZVRPP
15	Mersin		Cega	2096	232/3	Are	240	217	52080			4660	56740	Konfirmuar nga ZVRPP
16	Ibrahim		Alla	2096	232/4	Are	20	217	4340			1020	5360	Konfirmuar nga ZVRPP
17	Feride		Radiqi	2096	239/2	Are	500	217	108500			9000	117500	Konfirmuar nga ZVRPP
18	I Pidentifikuar			2096	661	Are	768	217	166656				166656	Konfirmuar nga ZVRPP
19	Demir	Merko	Biloshmi	2096	363/5	Are	1380	217	299460			60270	359730	Konfirmuar nga ZVRPP

20	Demir	Merko	Biloshmi	2096	363/4	Are	195	217	42315				42315	Konfirmuar nga ZVRPP	
21	Hekuran	Ramadan	Radiçi	2096	364/9	Are	169	217	36673				21250	Konfirmuar nga ZVRPP	
22	Hyrrije	Nuredin	Radiçi	2096	364/10	Are	180	217	39060				10600	Konfirmuar nga ZVRPP	
23	Isuf		Radiçi	2096	364/11	Are	210	217	45570				11760	Konfirmuar nga ZVRPP	
24	Hajdar	Sejfulla	Radiçi	2096	364/12	Are	255	217	53335				20770	Konfirmuar nga ZVRPP	
25	Hyrrije	Demir	Radiçi	2096	364/13	Are	640	217	138880				30920	Konfirmuar nga ZVRPP	
26	Dilo	Dilaver	Radiçi	2096	364/14	Are	510	217	110670				20900	Konfirmuar nga ZVRPP	
27	Bajram		Radiçi	2096	364/15	Are	788	217	170996				21400	Konfirmuar nga ZVRPP	
28	I Pidentifikuar			2096	369/1	Are	110	217	23870				23870	Konfirmuar nga ZVRPP	
29	I Pidentifikuar			2096	370/1	Are	80	217	17360				17360	Konfirmuar nga ZVRPP	
30	Eduart	Xhevat	Gjymenga	2096	370/8	Are	490	217	106330				37550	Konfirmuar nga ZVRPP	
31	Feride		Radiçi	2096	370/9	Are	605	217	131285				117200	Konfirmuar nga ZVRPP	
32	Bujar		Radaku	2096	369/2	Are	190	217	41230				6010	Konfirmuar nga ZVRPP	
33	Shahin		Osmeria	2096	418/6	Are	120	217	26040				18190	Konfirmuar nga ZVRPP	
34	Hysen		Osmeria	2096	418/4	Are	115	217	24955				13690	Konfirmuar nga ZVRPP	
35	Mersin		Osmeria	2096	418/1	Are	300	217	65100				25490	Konfirmuar nga ZVRPP	
36	Ruzhdi		Vasku	2096	420/9	Are	550	217	119350					119350	Rikonfirmim
37	Haziz		Oyra	2096	420/8	Are	910	217	197470					197470	Konfirmuar nga ZVRPP
		TOTALI					16788		3375574	847	77924	619630	4073128		

KËRKESË
Nr.2845/3, datë 26.7.2010

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Qafë-Thanë-Lin-Pogradec”, loti I.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë t’i paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Sqarojmë që kjo shpallje kërkesë për shpronësim bëhet vetëm për pasurinë e llojit arë.

Pronarët për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP” do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë të rifreskuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim, të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE
DREJTORIA E SHPRONESIMEVE

Lista e pronareve qe shpronesohen nga ndertimi i segmentit rrugor "Qafe Thane-Lin-Pogradec" Loti I

Nr. Emri	Atesia	Mbiemri	Z.K.	Nr. Pasurise	Sip. Totale	Lloji i Pasurise			Vlera Totale (Leke)	Shenime
						ARE		Vlera		
						Sip.	Cmimi			
1	Resul Dalip	Avdillari	2457	113/1	2400	1138	264.3	300773.4	300773.4	Konfirmim ZVRPP
2	Braim	Turka	2457	186/21	640	233	264.3	61581.9	61581.9	Konfirmim ZVRPP
3	Nafi	Sullollari+bp	2457	186/24	560	250	264.3	66075	66075	Konfirmim ZVRPP
4	Izja	Korance	2457	186/16	560	265	264.3	70039.5	70039.5	Konfirmim ZVRPP
5	Kalosh Bezat	Avdullari+bp	2457	186/15	400	185	264.3	48895.5	48895.5	Konfirmim ZVRPP
6	Genci	Brazhde	2457	186/14	420	140	264.3	37002	37002	Konfirmim ZVRPP
7	Besnik	Bashalli	2457	186/12	300	69	264.3	18236.7	18236.7	Konfirmim ZVRPP
8	Bane	Korance	2457	186/10	510	156	264.3	41230.8	41230.8	Konfirmim ZVRPP
9	Mihal	Shegani+bp	2457	186/9	160	102	264.3	26958.6	26958.6	Konfirmim ZVRPP
10	Jovan	Bice	2457	186/8	620	177	264.3	46781.1	46781.1	Konfirmim ZVRPP
11	Millan	Kollee	2457	186/7	400	81	264.3	21408.3	21408.3	Konfirmim ZVRPP
12	Fuat	Bashalli	2457	186/5	700	57	264.3	15065.1	15065.1	Konfirmim ZVRPP
13	Besmi	Turka	2457	186/4	560	7	264.3	1850.1	1850.1	Konfirmim ZVRPP
14	Kristaq Klima	Anastasi	2457	232/40	400	370	264.3	97791	97791	Konfirmim ZVRPP
15	Kozma	Gjore	2457	232/39	160	125	264.3	33037.5	33037.5	Konfirmim ZVRPP
16	Todi	Gjore	2457	232/38	320	95	264.3	25108.5	25108.5	Konfirmim ZVRPP

17	I Paidentifikuar		2457	232/37			72	264.3	19029.6	19029.6	Konfirmim ZVRPP
18	Selman Jakup	Sullolari	2457	232/36	560		78	264.3	20615.4	20615.4	Konfirmim ZVRPP
19	Hasan	Myslia	2457	232/35	460		51	264.3	13479.3	13479.3	Konfirmim ZVRPP
20	Dhori	Bice	2457	232/34	500		51	264.3	13479.3	13479.3	Konfirmim ZVRPP
21	Lefter	Avdullari	2457	232/43	2860		171	264.3	45195.3	45195.3	Konfirmim ZVRPP
22	Kozam	Bale	2457	232/31	400		27	264.3	7136.1	7136.1	Konfirmim ZVRPP
23	Koli	Bale	2457	232/30	240		23	264.3	6078.9	6078.9	Konfirmim ZVRPP
24	Xhevat	Korance	2457	232/29	560		26	264.3	6871.8	6871.8	Konfirmim ZVRPP
25	Seit	Bashalli	2457	232/28	560		38	264.3	10043.4	10043.4	Konfirmim ZVRPP
26	Hekuran	Turka	2457	232/27	320		48	264.3	12686.4	12686.4	Konfirmim ZVRPP
27	Barije	Kreka	2457	232/26	520		24	264.3	6343.2	6343.2	Konfirmim ZVRPP
28	Mihal	Shegani	2457	232/25	560		52	264.3	13743.6	13743.6	Konfirmim ZVRPP
29	Vangjel	Shukle	2457	232/24	400		57	264.3	15065.1	15065.1	Konfirmim ZVRPP
30	Eqerem	Bashalli	2457	232/23	240		30	264.3	7929	7929	Konfirmim ZVRPP
31	Dylber	Bashalli	2457	232/22	400		20	264.3	5286	5286	Konfirmim ZVRPP
32	Xhemil	Latollari	2457	232/18	480		21	264.3	5550.3	5550.3	Konfirmim ZVRPP
33	Rexhai	Pashollari	2457	232/21	400		48	264.3	12686.4	12686.4	Konfirmim ZVRPP
34	Ili	Bale	2457	232/20	320		47	264.3	12422.1	12422.1	Konfirmim ZVRPP
35	Durim	Sullolari	2457	232/19	480		39	264.3	10307.7	10307.7	Konfirmim ZVRPP
36	Ikbal	Avdullari	2457	231/15	240		28	264.3	7400.4	7400.4	Konfirmim ZVRPP
37	Naum	Bice	2457	231/14	320		74	264.3	19558.2	19558.2	Konfirmim ZVRPP
38	Thanas	Bice	2457	231/13	340		91	264.3	24051.3	24051.3	Konfirmim ZVRPP
39	Demir	Bashalli	2457	231/12	680		208	264.3	54974.4	54974.4	Konfirmim ZVRPP
40	Njazi	Avdullari	2457	231/11	500		80	264.3	21144	21144	Konfirmim ZVRPP
41	Ekuran	Bashalli	2457	231/10	340		45	264.3	11893.5	11893.5	Konfirmim ZVRPP
42	Metali	Bashalli	2457	231/9	340		106	264.3	28015.8	28015.8	Konfirmim ZVRPP
43	Filip	Petre	2457	231/8	720		38	264.3	10043.4	10043.4	Konfirmim ZVRPP
44	Oran	Bashalli	2457	277/6	1100		48	264.3	12686.4	12686.4	Konfirmim ZVRPP
45	Liric	Bashalli	2457	277/5	240		37	264.3	9779.1	9779.1	Konfirmim ZVRPP

46	Gjergji	Bice	2457	277/4	1248	16	264.3	4228.8	4228.8	4228.8	Konfirmim ZVRPP
		Shuma				5144			1359559.2	1359559.2	

KËRKESË
Nr.3754/3, datë 23.7.2010

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Vlorë-Orikum.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Pasuritë për të cilat nuk janë të identifikuar dhe është bërë shënimi plotësim dokumentacioni dhe rikonfirmim do të kërkohet dhe një herë rikonfirmimi përfundimtar nga zyra e regjistrimit Vlorë, pasi këto të dhëna janë të pasakta.

Vlera totale për sipërfaqen e tokës arë prej 7409 m² është 1 538 487 (një milion e pesëqind e tridhjetë e tetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë, si dhe me një vlerë shpronësimi për drufrutorët prej 852 470 (tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind e shtatëdhjetë) lekësh, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 2 390 957 (dy milionë e treqind e nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekësh.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

**MPPT
DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE
DREJTORIA SHPRONESIMEVE**

**Lista e pasurive qe shpronosohen
nga zgjerimi i segmentit rrugor Vlore-Orikum**

Nr.	Pronari		Zona kad.	Nr./pas	Sip.m2	Lloji Pasurise	Çmimi	Vlefte	Shenime
	Emri	Atesia							
1	Petref		3140	377/3	67 are		234.5	15711.5	konfirmuar
2	Erion		3140	382/18	175 are		234.5	41037.5	konfirmuar
3	B/pronesi		3140	382/5	72 are				konfirmuar
4	Zaharian		3140	528/3	36 are		234.5	8442	konfirmuar
5	Nuro		3140	382/6	82 are		234.5	19229	konfirmuar
6	Elvira		3140	382/10	100 are		234.5	23450	konfirmuar
7	Agim		3140	382/7	129 are		234.5	30250.5	konfirmuar
8	Nuro		3140	382/3	232 are		234.5	54404	konfirmuar
9	Agim		3140	382/2	127 are		234.5	29781.5	konfirmuar
10	Arif		3140	382/1	286 are		234.5	67067	konfirmuar
11	Agim		3140	384/1/1	401 are		234.5	94034.5	konfirmuar
12	Agim		3140	383/1	332 are		234.5	77854	konfirmuar
13	Çerçiz		3140	391/3	277 are		234.5	64956.5	konfirmuar
14	Çerçiz		3140	389/1	83 are		234.5	19463.5	konfirmuar
15	Roland		3140	389/2	179 are		234.5	41975.5	konfirmuar
16	Roland		3140	391/1	111 are		234.5	26029.5	konfirmuar
17	Tare		3140	389/3	23 are		234.5	5393.5	konfirmuar
18	Tare		3140	391/2	129 are		234.5	30250.5	konfirmuar
19	B/Pronare Selmanaj		3140	405/11	38 are		234.5	8911	konfirmuar

20	Xhevit	Selmanaj	3140	409/3	41	are	234.5	9614.5	konfirmuar
21	Hader	Selmanaj	3140	409/9	317	are	234.5	74336.5	konfirmuar
22	B/pronesi		3140	69/2	83	pemetore	234.5	19463.5	konfirmuar
23	B/pronesi Karagozi		3140	103/1	47	pyll	263	12361	konfirmuar
24	I paidentifikuar		3140	407/7	71				Plotesim Dok. (ndarje pasurie) Rikonfirmim
25	Bardho	Ramo	3140	69/1	95	are	234.5	22277.5	konfirmuar
26	Pellat	Limo	3140	102/1	131	are	234.5	30719.5	konfirmuar
27	Cane	Ramo	3140	102/3	84	are	234.5	19698	konfirmuar
28	Ismail	Ramaj	3140	102/4	84	are	234.5	19698	konfirmuar
29	Panajot	Gjimara	3140	102/5	248	are	234.5	58156	konfirmuar
30	Arben	Pellumbi	3140	102/6	127	are	234.5	29781.5	konfirmuar
	Xhevdet Piro	Golemaj Stefa							
31	Andi	Gjikhuri	3140	102/8	175	are	234.5	41037.5	konfirmuar
32	Ylli	Sulaj	3140	102/10	144	are	234.5	33768	konfirmuar
33	Xhebro	Havari	3140	102/11	145	are	234.5	34002.5	konfirmuar
34	I paidentifikuar		3140	102/7	133				(ndarje pasurie) Rikonfirmim
35	I paidentifikuar		3140	102/9	324				Plotesim Dok. (ndarje pasurie) Rikonfirmim
36	Fadil	Nika	3140	102/12	48	are	234.5	11256	konfirmuar
37	Veip	Durmishi	3140	141/1	360	are	234.5	84420	konfirmuar

38	B/pronare Nikaj		3140	141/2	386 are	234.5	90517	konfirmuar
39	B/pronare Nikaj		3140	144/4	331 are	234.5	77619.5	konfirmuar
40	Novruz	Novruzi	3140	144/5	148 are	234.5	34706	konfirmuar
41	I paidentifikuar		3140	149/8	254			Plotesim Dok. (ndarje pasurie) Rikonfirmim
42	Nexhmie	Beqiri	3140	149/13	103 are	234.5	24153.5	konfirmuar
43	Ali	Gjimara	3140	148/4	129 are	234.5	30250.5	konfirmuar
44	B/Pronare Kapo		3140	148/1	149 are	234.5	34940.5	konfirmuar
45	Mehmet	Dani	3140	209/4	173 are	234.5	40568.5	konfirmuar
46	Vasil	Bilani	3140	504/1	105 are	234.5	24622.5	konfirmuar
47	Fatjon	Veizaj	3140	516/1	95 are	234.5	22277.5	konfirmuar
	SHUMA				7409		1538487	

MPPT
DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE
DREJTORIA SHPRONESIMEVE

Lista e pronareve qe shpronsohen per drufrutoret
nga zgjerimi i segmentit rrugor Vlore-Orikum

Nr.	Pronari		Zona kad.	Nr /pas	Sip.m2	Lloji Pasurise	Rrenje ve	Vlefte	Shenime
	Emri	Atesia							
1	Petref	Xhaferr	Mustafaj	3140	377/3	67 Nespulla Ulli	3 2	40100	konfirmuar ZRPP konfirmuar ZRPP
2	Arif	Avdi	Bego	3140	382/1	286 Ulli Mandarina	18 7	309170	konfirmuar ZRPP konfirmuar ZRPP
3	Nuro		Vero	3140	382/6, 382/3 382/2, 384/1/1	314 Ulli	2	29600	konfirmuar ZRPP
4	Agim	Hodo	Bego	3140	383/1, 382/7	989 Ulli Mandarina	32 6	473600	konfirmuar ZRPP
	SHUMA					1656		852470	

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-eksponitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 17.8.2010

Doli nga shtypi më 19.8.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 36 lekë